

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI

I KURSIT TË UNIFIKUAR

PUNIME DRURI

Kodi: PK-C-3-21

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2021

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME DRURI”

(PK-C-3-21)

I. Profili Profesional i punuesit të drurit

a) *Karakteristikat e punuesit të drurit*

Punuesi i drurit është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në ndërmarrje të ndryshme prodhuese ose mirëmbajtje, reparte dhe mini-reparte të ndryshme të punimit të drurit.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punuesi i drurit duhet të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehi* praktike që lidhen me veprimtarinë profesionale të punuesit të drurit.

Suksesi i punuesit të drurit është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) *Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e punuesit të drurit:*

Profesioni i punuesit të drurit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për realizimin e punimeve me dru dhe me prodhime gjysmë të gatshme prej druri si (rimeso, melaminë, kompensatë, pllakë zdrukthi, MDF, pllakë fibre, dru i shtresuar etj.) në elementë për prodhimin e dyerve, mobilieve të ndryshme, prodhimeve artistike, riparimeve, prodhimin e varkave prej druri, prodhimin e lodrave prej druri, veshje të sipërfaqeve me dru, tapiceri etj. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e punuesit të drurit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimin nëpërmjet punës, një punues druri mund të ndër marrë disa funksione mbikëqyrëse, duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit të përpunimit të drurit.

Për të zhvilluar aktivitetet privat dhe për vetëpunësim, në fushën e punimit të drurit duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Punime druri dhe të tjerë të ngjashëm”, me kod 7522, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: makinist për përpunimin e drurit, montues i objekteve prej druri, prodhues i lëndës së sharruar, karpentier, mirëmbajtës të prodhimeve prej druri etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Punime druri

Në përfundin të Kursit për Punime druri, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik për punime druri.
- Bëjnë organizimin e vogël të punës në repartin e punimeve të drurit.
- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet dhe makineritë e duhura të punës.
- Përzgjedhin materialet e duhura të punës.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës.
- Përdorin vizatime teknike dhe interpretojnë skica dhe projekte të thjeshta të punimeve me dru.

- Kryejnë vizatime dhe matje të ndryshme në punime prej druri.
- Kryejnë punime të drurit me vegla dhe pajisje dore;
- Kryejnë punime të drurit me makinat bazë të përpunimit të tij.
- Prodhojnë objekte prej druri masiv;
- Prodhojnë objekte prej druri dhe të kombinuara me prodhime gjysëm të gatshme prej druri si me melamine, rimeso, kompensatë, pllakë zdrukthi, fibre etj.
- Riparojnë objekte prej druri masiv apo gjysmë të gatshme.
- Kryejnë ambalazhime të produkteve prej druri.
- Montojnë në objekt produkte prej druri.
- Kryejnë llogaritjet e thjeshta ekonomike për punimet e drurit.
- Zbatojnë standardet e profesionit gjatë punimeve me dru.
- Zbatojnë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të drurit.
- Komunikojnë me etikë me eprorët, kolegët dhe klientët

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për Punime druri.

Pjesmarrësit në Kursin “Punime druri” duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për Punime druri

360 orë mësimore, ku
1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për Punime druri

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e punuesit të drurit	MK-09-297-21	40 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori; 30% Praktikë; 10% Vleresime;	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të punuesit të drurit. 2. Kursanti përshkruan objektet kryesore të punimeve prej druri. 3. Kursanti përshkruan mjedisin dhe mjetet e punës në punimet e drurit. 4. Kursanti përshkruan materialet që përdoren në punimet e drurit. 5. Kursanti interpreton vizatime dhe përgatit skica të thjeshta për punimet e drurit. 6. Kursanti kryen shënime, matje dhe kontrolle në punimet e drurit. 7. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.
2	Punime druri me vegla dore, mjete të mekanizuara të dorës dhe makina.	MK-09-298-21	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përpërgatit proceset e punimit të drurit. 2. Kursanti kryen punime të drurit me vegla dore. 3. Kursanti kryen punime të drurit me mjete të mekanizuara të dorës. 4. Kursanti kryen punime të drurit me makina bazë.

3	Punime ngjitjeje, montimi dhe Ilustrimi të detaleve prej druri.	MK-09-299-21	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit ngjitjen, montimin dhe Ilustrimin e detaleve prej druri. 2. Kursanti kryen punime të thjeshta ngjitjeje të detaleve prej druri. 3. Kursanti kryen punime montimi të detaleve prej druri. 4. Kursanti kryen punime Ilustrimi në sipërfaqen e drurit.
4	Punime të objekteve prej druri masiv.	MK-09-300-21	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit punimin e objektit prej druri masiv. 2. Kursanti punon materialin drunor. 3. Kursanti monton dhe përfundon objektin prej druri masiv.
5	Punime me prodhime gjysmë të gatshme prej druri.	MK-09-301-21	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit punime me prodhime gjysmë të gatshme prej druri. 2. Kursanti punon prodhime gjysmë të gatshme prej druri. 3. Kursanti monton elementët e përgatitur me prodhime gjysmë të gatshme prej druri.
6	Shtrimi i sipërfaqeve me dërrasa	MK-09-302-21	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit shtrimin e sipërfaqeve me dërrasa. 2. Kursanti vendos trarët mbështetës. 3. Kursanti shtron sipërfaqen me dërrasa.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për Punime druri

1. Moduli “Hyrje në profesionin e punuesit të drurit”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E PUNUESIT TË DRURIT	MK-09-297-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me mjedisin dhe organizimin e punës, me objektet, veglat, pajisjet dhe materialet e punuesit të drurit, me veçoritë dhe kërkesat e këtij profesioni, me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit, si dhe i aftëson ata për të kryer matjet e nevojshme e për të interpretuar skica të thjeshta që lidhen me punimet e drurit.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori; 30% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Kërkesat e pranimit	Kursantët duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të punuesit të drurit. <i>Kriteret e vlerësimit</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të rendisë detyrat dhe punimet e punuesit të drurit;– të përshkruajë mjedisin, vendin dhe kushtet e punës për punuesin e drurit;– të përshkruajë kërkesat profesionale të punuesit të drurit;– të tregojë mundësitë e përparimit në profesionin e punuesit të drurit;– të tregojë si bëhet organizimi i vogël i punës dhe ndarja e përgjegjësisive në punimet e drurit;– të përshkruajë dokumentacionin që përdoret në organizimin e punës së punuesit të drurit;– të tregojë pasojat nga mos-respektimi i rregullave të sigurisë në punë.– të shpjegojë masat që merren për ruajtjen e mjedisit gjatë punimeve prej druri. <i>Instrumentet e vlerësimit:</i> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli.– Pyetje – përgjigje me gojë. RM 2 Kursanti përshkruan objektet kryesore të punimeve prej druri <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të bëjë klasifikimin e përgjithshëm të objekteve dhe prodhimeve gjysmë të gatëshme prej druri;– të përshkruajë orenditë e zakonshme që përdoren për mjedise të ndryshme, llojet, veçoritë e ndërtimit, materialet përbërëse dhe përdorimet e tyre;	

- të përshkruajë dyert dhe dritaret e ndërtesave, kapriata të thjeshta, llojet, veçoritë e ndërtimit, materialet përbërëse dhe përdorimet e tyre;
- të përshkruajë veshjet e ndryshme për tavane, mure, dysheme dhe shkallë, llojet, veçoritë e ndërtimit, materialet përbërëse dhe përdorimet e tyre;
- të përshkruajë objekte të veçanta prej druri, llojet, dhe veçoritë e ndërtimit të tyre.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

RM 3 Kursanti përshkruan mjedisin dhe mjetet e punës në punimet e drurit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bëjë klasifikimin e veglave, mjeteve të mekanizuara, makinave, pajisjeve dhe instrumentave të punës;
- të përshkruajë veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makinat, pajisjet dhe instrumentat pajisjet për sharrimin e materialit drunor, llojet dhe përdorimet e tyre;
- të përshkruajë veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makinat, pajisjet dhe instrumentat për zdrukthimin, planimin e materialit drunor, llojet dhe përdorimet e tyre;
- të përshkruajë veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makinat, pajisjet dhe instrumentat për frezimin e materialit drunor, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të përshkruajë veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makinat, pajisjet dhe instrumentat për zumparimin e materialit drunor, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të përshkruajë pajisjet, makinat për lyerje, ilustrimin e materialit drunor të punuar, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të përshkruajë veglat dhe pajisjet për montimin e elementeve prej druri dhe pllakave gjysëm të gatshme, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së veglave, mjeteve të mekanizuara të dorës, makinave, pajisjeve dhe instrumentave të punës në repartet e punimit të drurit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti përshkruan materialet që përdoren në punimet e drurit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bëjë klasifikimin e përgjithshëm të materialeve të punimeve prej druri;
- të dallojë dhe përshkruajë lëndët e drurit, llojet, vetitë dhe përdorimet e tyre;

- të dallojë prodhimet gjysmë të gatshme prej druri, llojet, vetitë dhe përdorimet;
- të dallojë dhe përshkruajë materialet ndihmëse, llojet, vetitë dhe përdorimet e tyre;
- të dallojë dhe përshkruajë aksesorët që përdoren në punimet prej druri, llojet, karakteristikat dhe përdorimet e tyre;
- të përshkruajë rregullat për magazinimin, ruajtjen dhe sistemimin e materialeve të nevojshme për punimet prej druri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti interpreton vizatime dhe përgatit skica të thjeshta për punimet e drurit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë dhe zbatojë rregullat për vizatimet e punimeve të drurit;
- të dallojë dhe përdorë simbolet për vizatimet e punimeve të drurit;
- të interpretojë drejt përmasat në vizatimet e punimeve të drurit;
- të interpretojë drejt shënimet teknike në vizatimet e punimeve të drurit;
- të përshkruajë dhe zbatojë rregullat në skicat e punimeve të drurit;
- të përgatisë skica të thjeshta të punimeve prej druri;
- të dallojë dhe përdorë simbolet në skicat e punimeve të drurit;
- të vendosë saktë përmasat dhe shënime teknike në skicat e punimeve të drurit;
- të përdorë si duhet mjetet e nevojshme për skicimet e punimeve të drurit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Kursanti kryen shënime, matje dhe kontrolle në punimet e drurit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të shpiegojë cilat janë matjet, shënimet dhe kontrollet kryesore që kryhen në proceset e punimit të drurit;
- të përdorë njësitë matëse përkatëse në punimet prej druri;
- të dallojë instrumentet për matjen, shënimin dhe kontrollin në punimet prej druri, të tregojë përdorimet e tyre;
- të kryejë saktë shënime të thjeshta, me kallëpe (shabllo);
- të matë me saktësi përmasat në punimet prej druri;
- të kontrollojë saktësinë e punimeve si këndet, horizontalitetin, vertikalitetin etj.;
- të llogaritë me kujdes sipërfaqe dhe vëllime të materialeve të punës;

- të ndërtojë dhe përdorë “tabelën e prerjes” për shfrytëzimin racional të prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri;
- të kujdeset për instrumentet dhe mjetet shënuese, matëse dhe kontrolluese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë.
- Kontroll i demonstrimit praktik

RM 7 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përdorë kompletin e veshjes dhe të mjeteve mbrojtëse të punuesit të drurit;
- të përdorë rutinë e ndihmës së shpejtë.
- të shpjegojë si jepet ndihma e parë për të dëmtuarit në punë;
- të përshkruajë dhe zbatojë rregullat bazë të mbrojtjes në punë;
- të përshkruajë dhe zbatojë rregullat e mbrojtjes nga zjarri;
- të dallojë mjetet e mbrojtjes nga zjarri dhe tregojë përdorimin e tyre;
- të përshkruajë dëmtimet kryesore të mjedisit gjatë punimeve prej druri;
- të marrë masat e duhura për eliminimin e dëmtimeve të mjedisit nga punimet e drurit;

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzimet për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në reparte të përpunimit të drurit. Rekomandohet që të bëhen vizita në kompani që kryejnë veprimtari në fushën e punimit të drurit.

- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të çështjeve që trajton moduli.
- Rekomandohet që instruktori të pajisë kursantët me materiale të shkruara, skica, udhëzuesa, rregullore, etj., në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
- Kursantët duhet të marrin pjesë aktivisht në realizimin e veprimeve praktike që parashikohen në modul, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Kursantët duhet të nxiten që të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë aktivisht në lidhje me problemet që trajtohen në modul.
- Gjatë vlerësimit të kursanteve, duhet të vihet më tepër theksi te kontrolli i zbatimit në praktikë të njohurive, koncepteve dhe fenomeneve të trajtuara, se sa te riprodhimi mekanik i tyre.

Baza materiale e domosdoshme

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, mkinat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë për mësimin teorik



-
- Reparte për punime druri.
 - Kompleti i veglave, mjeteve të mekanizuara të dorës, makinat, pajisjet dhe instrumentat për punime drurit. Mjetet shënuese, matëse dhe kontrolluese të punuesit të drurit.
 - Mjetet për skicime të objekteve prej druri.
 - Materiale pune për punime druri.
 - Pankarta, skica, makete, udhezues, rregullore, etj.
 - Materiale te ndryshme në mbështetje të modulit (manuale, rregullore, udhëzues, CD, filmime, etj.).
-

2. Moduli “Punime druri me vegla dore, mjete të mekanizuara të dorës dhe makina”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PUNIMET DRURI ME VEGLA DORE, MJETE TË MEKANIZUARA TË DORËS DHE MAKINA	MK-09-298-21
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët për të kryer punime druri të thjeshta si sharrim, planim, birim, zumparim, frezim etj., me vegla dore, mjete të mekanizuara të dorës dhe me makina bazë të përpunimit të drurit.	
Kohëzgjatja e modulit	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Kërkesat e pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulën “Hyryje në profesionin e punuesit të drurit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti parapërgatit proceset e punimit të drurit. <i>Kriteret e vlerësimit</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të interpretojë skicën për llojet e punimeve të drurit sipas modelit; – të përgatitë materialin drunor sipas kërkesës, për kryerjen e proceseve; – të kontrollojë instrumentat prerës sipas veçorive; – të përgatitë veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makina bazë të përpunimit të drurit, pajisjet për kryerjen e procesit të sharrimit të drurit duke përkrahur veçoritë; – të përgatitë veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makina bazë të përpunimit të drurit, pajisjet për kryerjen e procesit të zdrukthimit të drurit duke përkrahur veçoritë; – të përgatitë përgatitë veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makina bazë të përpunimit të drurit, pajisjet për kryerjen e procesit të shpimit të drurit duke përkrahur veçoritë përkatëse; – të përgatitë veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makina bazë të përpunimit të drurit, pajisjet për kryerjen e procesit të daltimit, frezimit të drurit duke përkrahur veçoritë përkatëse; – të përkrahujë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së veglave, mjeteve të mekanizuara të dorës, makinave bazë të përpunimit të drurit, pajisjeve të kryerjes së punimeve të drurit. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – Pyetje-përgjigje me gojë – Vëzhgim me listë kontrolli 	
	<p>RM 2 Kursanti kryen punime druri me vegla dore. <i>Kriteret e vlerësimit</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të kryejë sharrime gjatësore, tërthore dhe të lakuara, me sharra 	

- dore;
- të kryejë zdrukthime të llojeve të ndryshme, me zdrukthet përkatëse;
- të kryejë shpime të llojeve të ndryshme, me trapano dore;
- të kryejë daltime të llojeve të ndryshme, me dalatat përkatëse;
- të kryejë zumparime të llojeve të ndryshme, me letra zumparuese dhe tamponet (papuçet) përkatëse;
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat e dorës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve, të drurit me vegla dore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti kryen punime druri me mjete të mekanizuara të dorës.

Kriteret e vlerësimit

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë sharrime të ndryshme me sharra elektrike dore (disk dhe fletë);
- të kryejë zdrukthime të llojeve të ndryshme, me zdrukth elektrik dore;
- të kryejë shpime të llojeve të ndryshme, me trapan dore elektrik;
- të kryejë frezime të llojeve të ndryshme, me frezë elektrike dore;
- të kryejë zumparime të llojeve të ndryshme, me zumparuese elektrike dore;
- të tregojë kujdesin e duhur për mjete të mekanizuara të dorës elektrike dhe pneumatike.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve të drurit me mjete të mekanizuara të dorës, elektrike dhe pneumatike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti kryen punime të drurit me makina bazë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë sharrime të ndryshme me makinën sharrë shirit apo disk sipas skicës;
- të kryejë shpime të ndryshme me makinën trapan vertikale apo horizontal sipas modelit;
- të kryejë zdrukthime të ndryshme me makinën plan-drejtues;
- të realizojë trashësinë e kërkuar të elementit prej druri në makinën “grosec”;
- të kryejë frezime të ndryshme me makinën frezë sipas modelit;
- të kryejë zumparime të ndryshme me makinën zumparuese;
- të tregojë kujdesin e duhur dhe bëjë mirëmbajtjen e makinave për punimet bazë të drurit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë

kryerjes së punimeve bazë të drurit me makina.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në reparte të përpunimit të drurit. Rekomandohet që të bëhen vizita në kompani që kryejnë veprimtari në fushën e punimit të drurit.

- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të çështjeve që trajton moduli.
- Rekomandohet që instruktori të pajisë kursantët me materiale të shkruara, skica, udhëzuesa, rregullore, etj., në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
- Kursantët duhet të marrin pjesë aktivisht në realizimin e veprimeve praktike që parashikohen në modul, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Kursantet duhet të nxiten që të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë aktivisht në lidhje me problemet që trajtohen në modul.
- Gjatë vlerësimit të kursanteve, duhet të vihet më teper theksi te kontrolli i zbatimit në praktikë të njohurive, koncepteve dhe fenomeneve të trajtuara, se sa te riprodhimi mekanik i tyre

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Reparti i i makinerisë të drurit.
 - Kompleti me veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makinat dhe pajisjet në punimet e drurit.
 - Lëndë drunore, prodhime gjysmë të gatëshme dhe materiale të tjera të nevojshme për kryerjen e punimeve bazë të drurit.
 - Pankarta, makete, skica, vizatime teknike dhe katalogje të punimeve të drurit.
 - Materiale te ndryshme në mbështetje të modulit (manuale, rregullore, udhëzuesa, CD, filmime, etj.).
-

3. Moduli “Punime ngjitjeje, montimi dhe ilustrimi të detaleve prej druri”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PUNIME NGJITJEJE, MONTIMI DHE LLUSTRIMI TË DETALEVE PREJ DRURI	MK-09-299-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të kryer punime me detale druri, ngjitjeje me lëndë ngjitëse, montim, lyerje me bojë ose llak, vendosje e aksesorëve metalikë dhe ambalazhim.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e punuesit të drurit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti parapërgatit ngjitjen, montimin dhe ilustrimin e detaleve prej druri. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për montim; – të përshkruajë metodat për montimin e detaleve prej druri, veçoritë dhe përdorimin e tyre; – të përgatisë dhe sistemojë elementet dhe pllakat prej druri për montim; – të organizojë vendin e punës për procese pune të lyerjes të pllakave dhe detaleve me lëndë ngjitëse, llak, bojra etj; – të përzgjedhë lëndën ngjitëse dhe llustruese sipas kërkesës; – të përzgjedhë mjetet, makinat e duhura për lyerje dhe llustrim sipas kërkesës; – të përcaktojë rradhën e punës të lyerjes të pllakave dhe detaleve me lëndë ngjitëse, llak, bojra etj nën mbykqyrje; – të përzgjedhë detalet apo pllakat, në të cilat do kryhen punimet e lyerjes me kimikate; – të përzgjedhë saktë, sipas modelit aksesorët e nevojshëm; – të përzgjedhë materialet e nevojshme për ambalazhimin e objekteve të drurit; – të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve për përgatitjen e vëndit të punës në sektorin e montimit të objekteve prej druri. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – Vëzhgim me listë kontrolli. – Pyetje-përgjigje me gojë <p>RM 2 Kursanti kryen punime të thjeshta ngjitje të detaleve prej druri <i>Kriteret e vlerësimit:</i></p>	

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë procese pune për përgatitjen e lëndës ngjitëse, sipas recetës nën mbykqyrje;
- të kryejë procese pune për të lyer me lëndë ngjitëse pllaka dhe detale prej druri me mjete të thjeshta me furcë me zhytje).
- të kontrollojë cilësinë e lyerjes me lëndë ngjitëse nën mbykqyrje;
- të ngjiti pjesët e lyera me lëndë ngjitëse;
- të pastrojë sipërfaqen e drurit dhe pllakat e lyera nga mbeturinat e lëndës ngjitëse;
- të kujdeset për veglat dhe paisjet e punës gjatë lyerjes.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës, për lyerjen me lëndë ngjitëse të pllakave dhe detaleve prej druri duke përdorur mjete të thjeshta.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë

RM 3 Kursanti kryen punime montimi të detaleve prej druri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë brinjët e pllakave të prera me temin;
- të birojë elementet për montim;
- të montojë paraprakisht elementët drunorë sipas modelit, për objektin përkatës, pa lëndë ngjitëse;
- të mënjanojë defektet në rast se do ketë;
- të montojë detalet me bulona, me vida, kunja, me thitha, kapse teli, gozhdë, thumba, me kënde plastikë ose metalikë sipas modelit;
- të aplikojë në detale dhe pllaka aksesorë metalikë dhe plastikë të nevojshëm sipas modelit, me mjetet dhe paisjet e nevojshme për montim;
- të kontrollojë, sipas kërkesës, cilësisë e montimit;
- të ambalazhojë sipas standartit punimet e përfunduara prej druri;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punime të montimit të detaleve prej druri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë

RM 4 Kursanti kryen punime Ilustrimi në sipërfaqen e drurit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të organizojë vendin e punës për lustrimin e sipërfaqes së drurit;
- të përcaktojë llojin e Ilustrimit, ngjyrën etj.;
- të llogaritë sasinë e lëndës ngjitëse të nevojshme sipas normativës;
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për lustrim;
- të përgatisë veglat, pajisjet dhe makinat për lustrim;
- të përgatitë sipërfaqen e drurit për lustrim;
- të zumparojë sipërfaqen e drurit sipas shkallës të pastërtisë;
- të përgatitë bojën, solucionin e lustrimit sipas recetës;
- të ngjyrosë sipërfaqen e drurit sipas kërkesës;
- të lyejë me pastë poliuretan për mbushjen e poreve në sipërfaqen e drurit;
- të thajë shtresën e pastës në mënyrë natyrore;
- të zumparojë me letër zumpare të imët sipërfaqen e drurit së lyer me pastë poliuretani;
- të pastrojë me kujdes sipërfaqen e zumaruar;
- të kontrollojë defekte të vogla të bojës dhe të poreve nëse ka sipërfaqja e drurit;
- të eliminojë defektet duke stukuar apo duke lyer me bojë;
- të lyejë me poliuretan sipërfaqen me splucim (me pistoletë);
- të thajë në mënyrë natyrore shtresën e Ilustrës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë lustrimit të sipërfaqeve të drurit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në reparte të montimit të drurit. Rekomandohet që të bëhen vizita në kompani që kryejnë veprimtari të ngjitjes, montimit dhe lustrimit të detaleve prej druri.

- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të montimit, ngjitjes, lyerjes me bojë ose lëndë Ilustruese, të detaleve dhe pllakave prej druri.
 - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të montimit, ngjitjes, lyerjes me bojë ose lëndë Ilustruese të detaleve dhe pllakave prej druri, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës, të montimit, ngjitjes dhe lyerjes, me bojë ose lëndë Ilustruese, të detaleve dhe pllakave prej druri.
 - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike
-

për realizimin e montimit, ngjitjes dhe lyerjes, me bojë ose lëndë ilustruese, të detaleve dhe pllakave prej druri.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimi të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për ngjitje, montim, lyerje dhe ilustrim.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime ngjitje montimi, lyerje dhe ilustrim.
 - Detale dhe pllaka të punuara, të gatshme për montim.
 - Lëndë ngjitëse dhe ilustruese, aksesore metalikë, mjete ambalazhimi.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Punime të objekteve prej druri masiv”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe Kodi	PUNIME TË OBJEKTEVE PREJ DRURI MASIV	MK-09-300-21
Qëllimi	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të punuar objekte prej druri masiv (p.sh., karrike, tavolina, dyer, kapriata të thjeshta, shkallë të brëndshme etj.), me përdorim të veglave, mjeteve të mekanizuara të dorës, makinave dhe pajisjeve përkatëse.	
Kohëzgjatja e modulit	70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë dhe 10% Vlerësime	
Kërkesat e pranimit	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e punuesit të drurit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM1	<p>Kursanti parapërgatit punimin e objektit prej druri masiv. <i>Kriteret e vlerësimit</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të analizojë drejt vizatimet ose skicat e objektit prej druri masiv (karrige, derë, dritare, shkallë, kapriatë e thjeshtë etj.) që do të punohet. – të skicojë detajet e objektit prej druri masiv. – të përcaktojë rradhën e punës për punimin përkatës. – të bëjë llogaritjen e saktë të materialeve të nevojshme për punimin e objektit prej druri. – të përzgjedhë materialet e duhura të punës. – të përzgjedhë veglat, pajisjet, instrumentet prerës, matës dhe kontrollues të nevojshme për përgatitjen e objektit prej druri. – të përcaktojë makinat e duhura për punë. – të bëjë vendosjen e materialeve, veglave, pajisjeve e instrumentave në vendet përkatëse të punës. – të rregjistrojë makinën për punimet përkatëse, nën mbykqyrje; <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – Pyetje-përgjigje me gojë – Vëzhgim me listë kontrolli
	RM 2	<p>Kursanti punon materialin drunor. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të matë dhe shënojë saktë në materialin e drunor. – të sharrojë dërrasat me makinë sharrë. – të shkurtojë detalet e objekteve me makinë sharrë. – të bëjë planimin e sipërfaqes të detalit me , makinë zdrukthuese, plan. – të realizojë trashësinë e detaleve në makinë „grosec“.

- të frezohet detalet sipas skicës, me makinë frezë.
- të shpojë detalet sipas skicës, me makinë trapan.
- të zumparohet sipërfaqet e detaleve të objektit përkatës me makina zumparuese, me zumparuese elektrike dore ose me dorë.
- të sistemojë detalet e punuara prej druri masiv sipas rregullave të caktuara.
- të tregojë kujdesin e duhur ndaj veglave, mjeteve të mekanizuara të dorës, makinave, pajisjeve dhe instrumentave prerës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së detaleve dhe pllakave për objekte prej druri masiv.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti monton dhe përfundon objektin prej druri masiv.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të matë, kontrollojë dhe shënojë saktë për punimet përfundimtare të objektit;
- të ngjitet detalet me lëndë ngjitëse përkatëse sipas standatit;
- të montojë detalet me bulona, vida, kunjë, thitha, pyka, kapse teli, thumba, me kënde plastike ose metalike sipas kërkesës;
- të vendosë aksesorët e nevojshëm, sipas modelit;
- të zumparohet dhe pastrojë objektin e përfunduar sipas kërkesës;
- të lyejë objektin prej druri masiv e solucion mbrojtës;
- të illustrojë sipas kërkesë objektin prej druri masiv;
- të kontrollojë dhe korrigjojë në fund parregullsi të mundshme të objektit;
- të kryejë ambalazhimin e nevojshëm të objektit;
- të tregojë kujdesin e duhur ndaj veglave, pajisjeve, instrumentave dhe makinave;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve përfundimtare për objektin prej druri masiv.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzimet për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në reparte të punimit të drurit. Rekomandohet që të bëhen vizita në kompani që kryejnë veprimtari në fushën e punimit të drurit.

- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrimet dhe demonstrimet konkrete për punimin e objekteve prej druri masiv.
- Rekomandohet që instruktori të pajisë kursantët me materiale

të shkruara, skica, udhëzuesa, rregullore, etj., në mbështetje të punimeve që trajtohen në modul. Ai duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë zbatimit të rregullave të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit, nga ana e kursantëve.

- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë në veprimtari konkrete për punimin e orendive prej druri masiv, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me rastet e ndryshme që paraqiten gjatë punës.
- Rekomandohet të zbatohet puna në grup e kursanteve, me ndarje të roleve midis tyre.
- Gjate vleresimit të kursanteve duhet të zbatohet sa më shumë kontrolli i demonstrimit praktik të njohurive dhe aftësive të fituara nga ata.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Reparti i i makinerisë të drurit.
 - Kompleti me veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makinat pajisjet, instrumentat në punimet e drurit.
 - Lëndë drunore masive.
 - Materiale të tjera ndihmëse të nevojshme për realizimin e objektit prej druri masiv.
 - Pankarta, makete, skica, vizatime teknike dhe katalogje të punimeve të drurit.
 - Materiale të ndryshme në mbështetje të modulit (manuale, rregullore, udhëzuesa, CD, filmime, etj.).
-

5. Moduli “ Punime me prodhime gjysmë të gatshme prej druri.”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME ME PRODHIME GJYSMË TË GATSHME PREJ DRURI	MK-09-301-21
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson kursantët për të kryer punime me prodhime gjysmë të gatshme prej druri si pllakë zdrukthi, pllakë fibre, dru i shtresuar etj.	
Kohëzgjatja e modulit	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e punuesit të drurit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti parapërgatit punime me prodhime gjysmë të gatshme prej druri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të rikujtojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit; – të organizojë vendin e punës për punime, me prodhime gjysmë të gatshme prej druri si pllakë zdrukthi, pllakë fibre, dru i shtresuar etj.; – të zbërthejë saktë skicat e punimeve me prodhime gjysmë të gatshme prej druri; – të përgatisë saktë rradhën e punimeve sipas skicës; – të përzgjedhë saktë materialet për punimet me prodhime gjysmë të gatshme prej druri; – të kontrollojë vetitë fiziko mekanike të prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri nën mbykqyrje; – të përzgjedhë dhe rregjistrojë, në mbykqyrje, veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makinat, pajisjet, instrumentat që nevojiten për punime me prodhime gjysmë të gatshme prej druri; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Vëzhgim me listë kontrolli. – Pyetje – përgjigje me gojë. <p>RM 2 Kursanti punon prodhime gjysmë të gatshme prej druri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – të vendosë saktë skuadrën në makinë; – të sharojë pllakën në makinën përkatëse sipas skicës; – të formatizojë pllakën në makinën e formatizimit sipas skicës; – të masë dhe shënojë elementet, sipas skicës; – të hapë kanalën e nevojshme në pjesët e prera të pllakave, 	

- sipas skicës;
- të shpojë pllakat sipas modelit, me trapano elektrike dore apo në makinat e shpimit me shumë punto;
- përgatitë faqet e thithave sipas përmasave;
- të kontrollojë cilësinë e punimeve sipas kërkesave teknike;
- të kujdeset ndaj veglave, pajisjeve, instrumentave dhe makinave;
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve, për përgatitjen e elementeve, me prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri si pllakë zdrukthi, fibre, kompensatë dru i shtresuar etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë

RM 3 Kursanti monton elementët e përgatitur me prodhime gjysmë të gatshme prej druri.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të montojë paraprakisht elementet e objektit sipas skicës
- të evidentojë gabimet e mundshme;
- të korrigjojë gabimet e evidentuara;
- të lyejë me bojë ose llak sipas kërkesës pllakën e zdrukthit, fibrës, kompensatës etj;
- të montojë me lëndë ngjitëse elementet e objektit përkatës, me pllakë zdrukthi, fibre, dru i shtresuar etj,;
- të fshijë me kujdes, lëndën ngjitëse të tepërt nga elementet e ngjitur;
- të vendosi menteshat sipas modelit në elementët prej pllakë zdrukthi, fibre, kompensate etj. sipas skicës;
- të vendosi aksesorë të tjerë të nevojshëm, sipas modelit të objektit me prodhime gjysmë të gatshme prej druri;
- të montojë mobilien në hapësirën e matur më parë;
- të kujdeset ndaj veglave, pajisjeve, instrumentave dhe makinave të përdorura;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e mobilies me prodhime gjysmë të gatshme prej druri si pllakë zdrukthi, fibre, dru i shtresuar etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje – përgjigje me gojë.

Udhëzimet për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në reparte të punimit të drurit. Rekomandohet që të bëhen vizita në kompani që kryejnë veprimtari në fushën e punimit të drurit me prodhime gjysmë të gatshme prej druri.

- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të çështjeve që trajton moduli.

-
- Rekomandohet që instruktori të pajisë kursantët me materiale të shkruara, skica, udhëzuesa, rregullore, etj., në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Kursantët duhet të marrin pjesë aktivisht në realizimin e veprimeve praktike që parashikohen në modul, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
 - Kursantët duhet të nxiten që të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë aktivisht në lidhje me problemet që trajtohen në modul.
 - Gjatë vlerësimit të kursanteve, duhet të vihet më tepër theksi te kontrolli i zbatimit në praktikë të njohurive, koncepteve dhe fenomeneve të trajtuara, se sa te riprodhimi mekanik i tyre

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Reparti i i makinerisë të drurit.
 - Kompleti me veglat, mjetet e mekanizuara të dorës, makinat dhe pajisjet në punimet e drurit.
 - Prodhime gjysmë të gatshme prej druri, lëndë drunore, dhe materiale të tjera të nevojshme për kryerjen e punimeve sipas modulit.
 - Pankarta, makete, skica, vizatime teknike dhe katalogje të punimeve me Prodhime gjysme të gatshme prej druri
 - materiale te ndryshme në mbështetje të modulit (manuale, rregullore, udhëzuesa, CD, filmime, etj.).
-

6. Moduli “Shtrimi i sipërfaqeve me dërrasë”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHTRIMI I I SIPËRFAQEVE ME DËRRASË	MK-09-302-21
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të shtruar sipërfaqe me dërrasë, të tilla si dysheme, tavane etj.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimimin e detyruar, të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e punuesit të drurit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Kursanti parapërgatit shtrimin e sipërfaqeve me dërrasa. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të kryejë saktë matjen e sipërfaqes për shtrim të tavanit, dyshemesë;– të përshtasë vendin e punës për shtrimin e tavanit, dyshemesë me dërrasë;– të përzgjedhë saktë veglat dhe mjetet e nevojshme për punë;– të grumbullojë trarët mbështetës sipas përmasave dhe numrit të caktuar;– të grumbullojë dërrasat e përgatitura për shtrim të tavanit, dyshemesë;– të transportojë me shumë kujdes trarët dhe dërrasat në vendin e duhur;– të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë grumbullimit dhe transportimit të trarëve dhe dërrasave; <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">– Pyetje- përgjigje me gojë.– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Kursanti shtron trarët mbështetës <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të kontrollojë nivelin e traut të parë, sipas standardit;– të nivelojë traun e fundit, duke iu referuar traut të parë;– të nivelojë trarët ndërmjetës duke iu referuar trarëve kufizues;– të bëjë fiksimin e saktë të trarëve anësorë të niveluar;– të bëjë saktë fiksimin e trarëve të ndërmjetëm;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë vendosjes dhe fiksimit të trarëve mbështetës në dysheme. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p>	

- Pyetje- përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti shtron sipërfaqen me dërrasa.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shtrojë saktë dërrasën e parë të tavanit, dyshemesë;
- të fiksojë siç duhet dërrasën e parë të tavanit, dyshemesë;
- të shtrojë me saktësi dërrasat në vazhdim;
- të fiksojë dërrasat duke i shtrënguar me morseta;
- të vendosë saktë kornizat anësore;
- të kryejë zumparimin e dërrasës së shtruar;
- të kryejë lyerjen e sipërfaqes së shtruar me ngjyrues, me dyll bletësh, me llak, me poliuretan etj. sipas kërkesës;
- të kujdeset për veglat mjetet dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë shtrimit të sipërfaqeve me dërrasë;

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje- përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunim drurit apo në hapësirat e duhura, shtëpi, lokale etj.

- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë demonstrimet konkrete të procedurave të shtrimit të sipërfaqeve me dërrasa.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari për kryerjen e punimeve në matje, prerje dhe shtrimin e sipërfaqeve me dërrasa, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të vlerësimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së punimit të drurit me poste pune për shtrimin e dyshemesë dhe tavanit me dërrasa.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime druri, shtrime me dërrasa.
 - Trarë dhe dërrasa të përgatitura për shtrimin e dyshemesë dhe tavanit.
 - Manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara, etj.
-